



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit Muhamet Balaj dhe Arben Hundozi anëtarë ekipi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	28
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	31

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Deçanit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP).

Sa i përket menaxhimit financiar, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet duhet edhe më tutje të përmirësohen. Në fushën e të hyrave duhet ti kushtohet më shumë rëndësi kontrolleve në respektimin e afateve ligjore gjatë shqyrtimit të ankesave nga tatimpaguesit. Edhe fusha e shpenzimeve është vlerësuar me parregullsi sidomos tek menaxhimi i prokurimeve, menaxhimin e pasurisë, obligimeve si dhe llogarive të arkëtueshme.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit ende mbetet sfida për Komunën e Deçanit. Nga 18 rekomandimet e dhëna në raportin e vitit të kaluar, vetëm tetë rekomandime ishin zbatuar dhe se, si rezultat i përsëritjes së rekomandimeve shumë mangësi në sistemet domethënëse të komunës mbesin të pa trajtuara.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për Komunën e Deçanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Çështje kyçe e auditimit

Në të gjitha rastet zyrtari i pasurisë regjistron pagesat në total si pasuri dhe jo sipas karakteristikave individuale të pasurisë duke mos i klasifikuar sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare nenit 5 - Klasifikimi i përgjithshëm.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Deçanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Deçanit kishte shpenzuar 95% të buxheti final për vitin 2019 që paraqet realizim të mirë në nivel të përgjithshëm.

Sa i përket menaxhimit financiar, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet duhet edhe më tutje të përmirësohen. Në fushën e të hyrave duhet ti kushtohet më shumë rëndësi kontrolleve në respektimin e afateve ligjore gjatë shqyrtimit të ankesave nga tatimpaguesit, si dhe për borxhlinjtë e komunës të mos ofrohen shërbime komunale pa e paguar borxhin. Edhe fusha e shpenzimeve është vlerësua me parregullsi sidomos tek menaxhimi i prokurimeve, menaxhimin e pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €):

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	Realizimi 2019	Realizimi-%-2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Burimet e Fondeve:	8,951,356	9,258,464	8,782,569	95%	7,918,284	7,532,046
Granti i Qeverisë - Buxheti	8,163,001	8,163,001	7,926,709	97%	7,607,137	6,781,963
Të bartura nga viti paraprak -	-	355,560	332,898	94%	19,078	194,077
Të hyrat vetjake	670,403	670,403	461,547	69%	277,109	466,112
Donacionet e brendshme	-	2,380	-	-	8,595	-
Donacionet e jashtme	-	8,260	8,208	99%	984	89,894
Financim nga Huamarrja	117,952	58,860	53,207	90%	5,381	-

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 307,108€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura, donacioneve dhe ndryshimeve buxhetore përmes vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 8,782,569€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2018.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €):

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Realizimi 2019	Realizimi -%- 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:	8,951,356	9,258,464	8,782,569	95%	7,918,284	7,532,046
Pagat dhe Mëditjet	5,399,876	5,422,381	5,266,809	97%	5,260,347	5,067,475
Mallrat dhe Shërbimet	1,230,474	1,177,683	1,156,447	98%	875,428	747,702
Shërbimet komunale	155,500	155,500	155,258	100%	105,325	116,641
Subvencionet dhe Transferet	90,000	91,500	89,343	98%	84,628	114,100
Investimet Kapitale	2,075,506	2,411,400	2,114,712	88%	1,592,556	1,486,128

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillesar ishte rritur për 22,505€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar për programin e shëndetësisë për kujdestaritë të cilat do të vazhdojnë të bartën në vitin 2020. Ndërsa në realizimin prej 97% të buxhetit final ka ndikuar edhe Vendimi i Qeverisë Nr.03/115 për kursime buxhetore në vlerë prej 123,000€ e të cilat ishin planifikuar për ngritjen e koeficienteve për një pjesë të stafit të komunës.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 52,791€, dhe se, ky buxhet ishte realizuar në masën prej 98%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 335,894€, duke përfshirë edhe të disa projekte të reja³. Komuna kishte shpenzuar 88% të buxhetit final, kjo si pasojë e lëndëve në OSHP me ç' rast ka përfunduar afati për zotimin e mjeteve, të hyrat vetjake të realizuara dhe të alokuara pas përfundimit të vitit fiskal si dhe të hyra vetjake të realizuara në dhjetor të vitit 2019 të cilat nuk kanë mundur të alokohen për shkak të mbylljes së vitit fiskal.

³ Projekti për zgjerimin e rrugës në qendër të Deçanit, Ndërtimi i bregut të lumit dhe Ndërtimi i rrugës për në bjeshkën e Strellcit.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2019 ishin në vlerë 551,628€. Këto të hyrat janë nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, taksa rrugore, nga qiraja, taksa për matjen e tokës etj. Kemi testuar gjithsej 15 mostra substanciale me vlerë 7,695€ dhe 25 mostra për pajtueshmëri.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	670,403€	670,403	551,628	82%	450,364	492,419

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë Komuna ka realizuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga gjykatat prej 17,000€ dhe gjobat nga policia në vlerë prej 113,000€).

Çështja A1 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja

Neni 31 pika 6 të Ligjit 06L/055 për Tatimin në pronën e paluajtshme përcakton që - "Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar me një vendim të arsyetuar".

Në gjashtë raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë shqyrtimi i tyre ka tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit nga 3.5 muaj deri në 6 muaj.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe mos kordinimit ndërmjet komisionit për shqyrtim të ankesave dhe verifikimit të pronës në terren në mënyrë efektive.

Ndikimi

Shqyrtimi i ankesave me vonesë nga autoritetet komunale dëmton marrëdhënien ndërmjet komunës dhe tatimpaguesve dhe paraqet shkelje ligjore.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollat që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 5,422,382€. Numri i të punësuarve i aprovuar me buxhet ishte 878 ndërsa në fund të vitit numri i tyre sipas payroll-it është 859. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar

33 punonjës ndërsa janë pensionuar 22 punonjës dhe një ka lënë punën në mënyrë vullnetare. Kemi testuar 34 mostra për teste substanciale në vlerë 10,565€ si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Dobësi në procesin e rekrutimit

Gjetja Sipas UA 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenit 6 pika 5 përcakton që -“Konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e shpallura me konkurs”.

Në tre nga pesë raste të audituara që i përkasin sektorit të arsimit, gjatë procesit të rekrutimit komuna nuk ka rishpallur konkurs, pasi që në këto konkurse ishte vetëm nga një kandidat i përgjegjshëm për të vazhduar me procedurat e testimit. Gjithashtu, në njërin prej rasteve kandidati në tre pyetjet e para të testimit me shkrim përgjigjet i kishte identike me përgjigjet në shabllonin e testit.

Kjo ishte rezultat i kujdesit jo të duhur në respektimin e kërkesave rregullative.

Ndikimi Nga mosrespektimi i konkurrueshmërisë në procesin e rekrutimit, komuna rrezikon të rekrutoj kandidat jo kualitativ.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi. Po ashtu, duhet të shtojë masat e sigurisë lidhur me qasjen në dokumente/testet për kandidatë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 1,333,183€, prej tyre ishin shpenzuar 1,311,706€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime kontraktuese tjera, derivate për vetura dhe ngrohje, furnizim për zyre, mirëmbajtje të ndërtesave, furnizim me pajisje të ndryshme etj. Kemi testuar 28 mostra për teste substanciale në vlerë 193,229€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Mangësi në angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Gjetja Sipas nenit 12 pika 4 të LSHC Nr.03/L-149, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”. Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara.

Gjatë vitit Komuna kishte angazhuar 80⁴ punonjës përmes MSHV-ve në drejtori të ndryshme. Për 72 punonjës komuna nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë formale (të thjeshtëzuar) të rekrutimit. Procesi i angazhimit të personave me marrëveshje të veçanta nuk është menaxhuar nga njësia e burimeve njerëzore por nga zyra e kryetarit të komunës dhe mungonin kërkesat nga njësitë kërkuese për nevojat e departamenteve për staf shtesë, prandaj konsiderojmë se nuk është bërë një vlerësim i drejt i nevojave për angazhimin e tyre.

Angazhimi i personave nuk është bërë për shërbime të veçanta apo detyra specifike në kuptim të ligjit por për pozita të rregullta të punës. Kjo ka ndodhur për shkak të numrit të kufizuar të stafit të aprovuar me buxhet dhe mosrespektimin e kërkesave ligjore.

Ndikimi Angazhimi i stafit me MSHV pa kërkesa nga njësitë kërkuese dhe pa procedura të thjeshtëzuara rrezikon punësimin e personave jo kompetent në mungesë të konkurrueshmëris.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit të stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.

Çështja B2 – Planifikim jo i mirë i kontratës

Gjetja Me kontratë kornizë, palët obligohen që kontratën ta përmbushin sipas kushteve kontraktuale dhe specifikacionit të kontratës.

Te pagesa në vlerë 4,261€ për “Mirëmbajtjen higjienike të objektit të administratës komunale dhe objekteve publike” në Deçan, kemi evidentuar se në kontratë ishin përfshirë më vonë edhe dy objekte tjera, ai i shtëpisë së komunitetit dhe i zjarrfikësve, ndonëse fillimisht nuk ishin pjesë e kontratës. Këto dy objekte kanë një sipërfaqe prej 980m² me kosto prej 0.66€/m² apo kosto mujore prej 646.80€ për muaj.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit të drejtë të paramasës dhe specifikacionit të nevojshëm të nevojave komunale.

Ndikimi Planifikimi jo i drejtë i specifikacionit të kontratës vështirëson menaxhimin efikas të kontratës sipas kushteve kontraktuale.

⁴ Në QKMF-15 prej të cilëve tetë infermiere; 14 në drejtori për buxhet dhe financa; 11 anketues në tatimin në pronë; tre asistent administrativ; gjashtë në urbanizëm, gjashtë në administratë, katër në drejtorin për urbanizëm, pesë në drejtorin për kulturë dhe sport, katër në turizëm dhe të tjerët në drejtori ndryshme.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj se njësitë kërkuese planifikojnë saktë dhe se bazohen në nevojat reale, me qëllim të menaxhimit efikas të kontratës.

Çështja A2 - Mangësi në procesin e blerjes/mos zhvillim i procedurave të prokurimit

Gjetja Neni 4 i Rregullës financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e parave publike, përcakton ndër të tjera se prokurimi është element thelbësor për shpenzimin e parave publike.

Te pagesa në vlerë 620€ për shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit (bileta të aeroplanit), identifikua se komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. Komuna nuk ka zhvilluar procedura të prokurimit edhe për shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit⁵. Kjo ka rezultuar si pasojë e kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin planifikimit dhe të ekzekutimit të shpenzimit të parave.

Ndikimi Mos zhvillimi i procedurave të prokurimit me rastin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik është në kundërshtim me kornizën ligjore dhe reflekton negativisht në menaxhimin efikas të parave publike.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se për çdo shpenzim për të cilin kërkohet proces i tenderimit duhet të zhvillohen procedura të prokurimit konform kriterëve të përcaktuara ligjore, në të kundërtën furnizimet e pa kontraktuara duhet të ndërpriten.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 91,500€, prej tyre ishin shpenzuar 89,343€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencione për entitete jopublike si: financimi i klubeve sportive, grupeve lokale të veprimit, shoqatave kulturore. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 26,200€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,411,400€, prej tyre ishin shpenzuar 2,114,712€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtje investive, financimi i objekteve të ndryshme kulturore, arsimore dhe memorialë dhe pajisje tjera. Kemi testuar 37 mostra për teste substanciale në vlerë 1,392,800€, si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁵ Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, janë rreth 2,500€.

Çështja A3 - Mospërputhje ndërmjet situacionit të punëve të kryera dhe specifikacionit të kontratës

Gjetja Sipas Udhëzuesit për prokurimin publik, pika 56 Kontrata Kornizë pika 10-Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Te pagesa në vlerë 130,000€ për *Ndërtimin e rrugëve lokale*⁶, kemi identifikuar mospërputhshmëri respektivisht tejkallim të sasisë në dy pozicione tek situacioni II i punëve të kryera në raport me specifikacionin financiar të kontratës. Sasia në situacionin e punëve të kryera, në pozicionin nr.1 ishte 14,324m³ ndërsa në specifikacionin e kontratës ishte 1,000m³, gjithashtu në pozicionin nr.2 ishte 15,150m³ ndërsa në kontratë ishin paraparë 8,000m³. Gjithashtu edhe te dy pagesa në vlerë 88,901€ për situacionin III të punëve të kryera kemi evidentuar tejkallim të sasisë, në pozicionin nr. 1 ishin 3,560m³ ndërsa në specifikacionin e kontratës ishin 1,000m³ po ashtu edhe te pozicioni nr.10 ishin 219m³ ndërsa në kontratë ishin paraparë 80m³.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin planifikimit të drejtë të paramasës respektivisht vlerësimit të drejtë të nevojave për punë.

Ndikimi Mospërputhshmëria ndërmjet situacioneve të punëve të kryera dhe specifikacionit të kontratës krijon paqartësi lidhur me nevojat reale për punë dhe ndikon në zbatimin e drejtë të kontratës sipas kushteve kontraktuale dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik.

⁶ Kontratat në vlerë prej 581,010€ me validitet prej 06.03.2019 deri me 06.03.2020.

Çështja A4 - Mangësi në menaxhim të kontratës

Gjetja Ligji i prokurimit publik, Rregullat dhe udhëzuesi për prokurimin publik, përcaktojnë kriteret për menaxhimin e kontratës. “Menaxhimi i kontratës është përgjegjësi e menaxherit të projektit dhe i cili duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë”.

Nga inspektimi fizik i projektit⁷ “*Renovimi i sallës së asamblesë komunale*”, në vlerë 18,742€ përkatësisht tek situacioni i parë i punëve të përfunduara dhe pagesës së realizuar në vlerë 10,546€, kemi identifikuar se punët për “furnizim me material dhe punimi i tavolinave të dimensioneve të ndryshme për pozicionet nga 7 deri 15” të situacionit të pranuar në vlerë 6,120€ nuk ishin realizuar ndonëse ishin përfshirë në situacionin e punëve të përfunduara. Gjithashtu kemi identifikuar vonesë në realizimin e kontratës. Kontrata ishte nënshkruar me dt. 05.12.2019 dhe ishte paraparë që punimet të përfundojnë deri me 05.01.2020. Dobësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në planifikimin dhe menaxhimin e drejtë të projekteve.

Ndikimi Parregullsitë në menaxhimin e kontratës kanë rezultuar me mos përfundimin e punëve sipas kushteve kontraktuale dhe dëmtimin e buxhetit për pagesën e punëve të përfunduara.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherëve të kontratave se nuk kryhet asnjë pagesë për punët të cilat nuk janë përfunduar. Po ashtu, duhet të sigurojë se kontratat përfundojnë sipas planit, në të kundërtën për çdo vonesë të paarsyeshme të aplikohen penalet për ditët në vonesë.

⁷ Në praninë edhe të menaxherit të kontratës ekzaminimi fizik i projektit është realizuar me datë 11.02.2020.

Çështja B3 - Regjistrim jo adekuat i shpenzimeve në kode ekonomik

Gjetja LMFPF, rregullat financiare dhe plani kontabël të SIMFK-së përcaktojnë kategoritë dhe kodet ekonomike sipas llojit të shpenzimit.

- Pagesa në vlerë 280,000€ për parapagim të investimeve kapitale, ishte klasifikuar në kodin ekonomik 31230-Ndërtimi i rrugëve lokale, ndërsa kodi adekuat sipas planit kontabël është 31910-Avanse për kategorinë e investimeve kapitale.
- Tri pagesa në vlerë totale 258,901€, ishin klasifikuar në kodin 31230-Ndërtimi i rrugëve lokale, ndërsa shpenzimet i takonin mirëmbajtjes investive dhe kodi adekuat sipas planit kontabël është 31270-Mirëmbajtja investive.
- Pagesa në vlerë 40,000€ për pajisje speciale mjekësore, ishte klasifikuar në kategorinë e investimeve kapitale, në kodin ekonomik 31660-Pajisje speciale mjekësore. Po ashtu, në faturën 43,200€, disa pozicione/furnizime në vlerë 10,260€ nuk e plotësonin kriterin që të definohen si shpenzime kapitale, ato do duhej klasifikuar në kategorinë mallra dhe shërbime në kodin ekonomik 13506 pajisje speciale mjekësore (më pak se 1,000€).
- Pagesa në vlerë 8,227€ për pajisje speciale mjekësore, ishte klasifikuar në kategorinë e investimeve kapitale, në kodin ekonomik 31660-Pajisje speciale mjekësore. Përderisa vetëm një pajisje në vlerë 1,114€ e plotësonte kriterin që të definohet shpenzim kapital.

Dobësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit buxhetor dhe klasifikimit jo të drejtë të shpenzimeve.

Ndikimi Planifikimi jo i duhur i ndarjeve buxhetore si dhe klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve nëpër kodet ekonomike ndikon negativisht në shpalosjen e drejtë të shpenzimit për lexuesin.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejtë konform kodeve ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B4 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimit

Gjetja Neni 39 i LMFP, përcakton se organizata buxhetore është përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Si rezultat i mos pagesës së obligimeve financiare me kohë përmes procedurave gjyqësore përkatësisht pagesave direkte nga Thesari ishin ekzekutuar nga buxheti i komunës pagesa në vlerë 579,619€⁸. Arsyet e mos pagesës me kohë të obligimeve ishte mungesa e mjeteve buxhetore si rezultat i planifikimit jo të drejtë të buxhetit.

Ndikimi Pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi B4 Kryetari të siguroj një planifikim të drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet duke respektuar afatet kohore të përcaktuara me LMFP.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 17,479,039€, pasurive jokapitale është 195,261€ ndërsa komuna nuk mban stoqe. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale për pasurinë kapitale në vlerë 2,427,884€. Në pasuri jokapitale ne kemi përdorur procedura analitike krahasuese dhe substanciale për qëllimin e saktësisë.

⁸ Në 13 raste, pagesat e testuara në vlerë totale prej 257,668€ (38,200€ ishin pagesa në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe 219,467€ ishin pagesa në kategorinë e investimeve kapitale) borxhi i përgjithshëm ishte 244,216€ kurse shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbarimit) ishin 13,452€.

Çështja B5 - Prezantim jo i drejt i pasurisë kapitale dhe jokapitale

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores për 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”. Më tutje, neni 22 pika 1 përcakton që zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Sipas nenit 6 pika 2 të së njëjtës rregulloreje çdo organizatë duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që e ka në menaxhim të saj. Regjistri duhet mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Ndërtimi i murit mbrojtës në varrezat e fshatit “Dubovik” me vlerë 6,845€ është regjistruar si 684,500€ duke mbivlerësuar pasurinë për 677,655€;
- 22 vetura të llojeve të ndryshme të cilat janë të vjetra dhe vlera e tyre në libra do duhej të ishte zero, ato nuk janë zhvlerësuar fare duke mbivlerësuar pasurinë kapitale neto për 70,615€;
- Objekti i shkollës fillore “Edmond Hoxha” nuk i takon Komunës së Deçanit por asaj të Junikut ndërsa ende figuron në regjistrat e pasurisë kapitale duke e mbivlerësuar pasurinë kapitale bruto për 256,660€;
- Është regjistruar si pasuri demolimi apo rrënimi i objekteve të vjetra të dy shkollave në fshatin “Isniq” dhe “Rostovicë” në vlerë prej 29,850€ shumë kjo e cila do duhej kapitalizuar në ndërtimin e shkollave të reja. Ndërsa Komuna nuk posedon dokumentacionin e ndërtimit të shkollave të reja meqë është financuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Auditori ka kufizim fushëveprimi në përcaktimin e vlerës së drejt të tyre në mungesë të evidencave;
- Nga investimet kapitale të vitit 2019 nuk janë regjistruar 17⁹ pagesa me vlerë prej 424,665€ duke nënvlerësuar pasurin kapitale;

⁹ Pagesat kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtje investive, pajisje mjekësore, veturë e ndihmës së shpejt dhe pajisje tjera.

- Komuna e Deçanit kishte marrëveshje me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) lidhur me zbatimin e masave të eficientës së energjisë me ç'rast MZHE ka investuar në dy shkolla në Deçan njëra në SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" me vlerë 71,318€ dhe tjetra në SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit" me vlerë 67,055€. MZHE kishte bërë dorëzim/pranimin e projektit ndërsa shumat e shpenzuara nuk janë regjistruar apo kapitalizuar objekteve shkollore; dhe
- Pasuria jokapitale nuk është zhvlerësuar fare në regjistrat e pasurive jokapitale dhe si e tillë është prezantuar në pasqyrat financiare duke e mbivlerësuar llogarinë e pasurisë për 95,000€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunktionalizimit të modulit të zhvlersimit në sistemin e-pasuria në vite. Gjithashtu pasuritë e blera nga mallrat dhe shërbimet në shumë prej 18,396€ nuk janë regjistruar fare në regjistrin e pasurive jokapitale.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së dizajnit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm në komunë me ç'rast informacionet relevante për regjistrimin e drejt të pasurisë nuk qarkullojnë në mënyrë të ndërsjellë në mes të departamentit të financave dhe zyrtarit të pasurisë.

Ndikimi

Prezantimi jo i drejtë i pasurive në pasqyra financiare dhe në regjistrat e pasurisë ndikon në vendimet e përdoruesve të informacioneve dhe keq menaxhimin e saj.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontroleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërën anë dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar modulën e zhvlersimit në sistemin e-pasuria si dhe regjistrimit e plotë të pasurive jokapitale në këtë sistem.

Çështja B6 - Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë jo financiare

Gjetja

Ne identifikuam si në vijim:

- Sipas nenit 3 të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare - ZKA formon komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare në OB me qëllim të inventarizimit vjetor apo periodik të pasurisë jo financiare.

Komuna ka themeluar komisionin e inventarizimit të pasurisë me dt.27.01.2020 duke e ngatërruar mandatin e komisionit të inventarizimit me atë të vlerësimit.

Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i mos kompetencës në të kuptuarit e drejt të kërkesave rregullative.

- Po ashtu, sipas nenit 19 pika 4.3 të rregullores së njëjtë - Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe – Krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jofinanciare. Si dhe pika 4.7 kërkon që raporti i përgjithshëm inventarizimit duhet të dorëzohet në një kohë të përshtatshme para përgatitjes së PVF-ve.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar raportin e përgjithshëm ndërsa nuk ka bërë krahasimin ndërmjet gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë. Ky raport është bërë final pas deklarimit të pasqyrave financiare¹⁰. Ky komision ka vendosur vlera në regjistrin e inventarizimit dhe nuk është e kuptueshme se si kanë arritur në atë vlerësim.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së njohurisë për kërkesat e rregullores dhe mungesa e një udhëzimi të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jofinanciare.

Ndikimi Dobësitë në procesin e inventarizimit të pasurisë financiare rrezikon që pasuria mos të prezantohet drejt në pasqyra financiare dhe ndikon në përdoruesit e informacioneve të pasurisë.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj hartimin e udhëzuesit të brendshëm të inventarizimit pastaj të formoj komisionin e inventarizimit të pasurisë jo financiare me mandat të qartë dhe se raporti përfundimtarë i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare duke i krahasuar shënimet me regjistrat e pasurisë financiare.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 1,619,360€. Të arkëtueshmet janë 1,603,563€ nga tatimi në pronë dhe 15,797€ nga pronat e dhëna me qira.

Çështja B7 - Menaxhim jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 29 të Ligjit 06L/055 për Tatimin në pronën e paluajjtshme “Nëse debitori nuk paguan detyrimet tatimore të papaguara në datën e përcaktuar për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, komuna brenda tre ditëve pune pas përfundimit të afatit për pagesë, pezullon shërbime të caktuara komunale për atë debitor, deri në pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara”. Po ashtu, sipas nenit 30 “Nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e

¹⁰ Raporti i inventarizimit është finalizuar me 25.02.2020 ndërsa PVF janë dorëzuar në MF me 28.01.2019.

300€. Vendimi merret brenda dhjetë ditëve pune”. Paragrafi 7 i nenit 30 kërkon që “Brenda dhjetë ditëve pune pas ditës së marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara, autoriteti që ka marrë vendimin kërkon autoritetit kompetent përmbaues përmbaimit e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbaimore. Një kopje e propozimit për përmbaimit së bashku me dokumentet e bashkëlidhura i dërgohen menjëherë debitorit”.

Ne identifikuam se në katër raste, përkundër që tatim paguesit ishin borxhli ndaj komunës për tatimin në pronë, këta kanë marrë shërbime komunale për pagesën e taksës rrugore.

Komuna e Deçanit në këtë vit ka prezantuar 1,603,563€ llogari të arkëtueshme, në totalin e kësaj vlerë të prezantuar në PFV nuk janë përfshi llogaritë e arkëtueshme nga shfrytëzimi i pronave komunale prej 15,491€, edhe pse janë shpalosur si analitik.

Në krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje prej 7.3% apo 110,446€ të këtyre llogarive. Komuna nuk ka ndërmarr masa në pezullimin e shërbimeve komunale dhe shfrytëzimin e rrugëve ligjore në arkëtimin e mjeteve për tatimpaguesit të cilët kanë borxhe të vjetra të papaguara ndaj komunës. Kjo ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur nga ana e menaxhmentit të komunës.

Ndikimi

Rritja e llogarive të arkëtueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe mungesa e përpjekjeve për të arkëtuar mjetet dobëson likuiditetin e komunës dhe ndikon në realizimin e ulët të projekteve nga fondet e pa mbledhura. Gjithashtu mungesa e informatave të plota për LLA, çorienton menaxhmentin në marrjen e vendimeve dhe nuk ofron pamje të drejtë për këtë llogari të prezantuar në PFV.

Rekomandimi B7 Kryetari komunës duhet të siguroj se ndërmerren masa në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme sipas ligjit mbi tatimin në pronë, sipas kontratave për pasuritë e dhëna në shfrytëzim, dhe duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve. Gjithashtu duhet shtohen kontrollet që kjo llogari të prezantohet drejt në PFV.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 480,171€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Në raport me vitin e kaluar kemi një rritje të këtyre detyrimeve për 203,171€.

Çështja A5 - Mos raportimi i obligimeve në Thesar

Gjetja Sipas nenit 5 të Rregullës Nr.02/2013/MF për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore - “Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave-Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara”. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore.

Komuna përgjatë vitit 2019 nuk ka bërë raportime mujore të obligimeve në Thesar. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të brendshme jo efikase dhe koordinimit jo të drejtë të detyrave në kuadër zyrës së financave.

Ndikimi Mungesa e raportimit financiar të obligimeve vështirëson përmbushjen me kohë të obligimeve financiare dhe mund të krijoj kosto shtesë si rezultat i procedimit për pagesë të obligimeve nga OE nëpërmjet procedurave gjyqësore.

Rekomandimi A5 Kryetari të siguroj ndërmarrjen e masave për përmirësimin e mekanizmave të brendshme të kontrollit lidhur me respektimin e kriterëve ligjore për raportim të rregullt të obligimeve financiare në MF-Thesar.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjente të prezantuara në pasqyra financiare janë 1,255,112€. Krahasuar me vitin e kaluar këto detyrime ishin rritur për 971,112€ dhe se kjo rritje e lartë pasqyron një nga vështirësitë buxhetore që komuna do të përballet në të ardhmen.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Deçanit ka të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm (NJAB) në të cilin operojnë drejtori dhe një anëtarë. Gjithashtu është i themeluar komiteti i auditimit i cili është funksional duke mbajtur katër takime në vitin 2019. NJAB kishte përfunduar gjashtë¹¹ auditime aq sa ishin planifikuar me planin vjetor. Në këto raporte janë dhënë 25 rekomandime, prej tyre 13 janë zbatuar, katër ishin në proces dhe tetë nuk janë zbatuar fare.

¹¹ Auditimi për pasuritë duke mbuluar periudhën 2018; shpenzimet nga të gjitha kategoritë për gjashtëmujorin e parë të vitit në departamentin e arsimit; fusha e prokurimit për katër mujorin e parë të vitit; të hyrat duke mbuluar vitin 2018 dhe dy muajt e vitit pasues; menaxhimi i shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve përfshi komunalit në QKMF duke mbuluar shtatë mujorin e parë të vitit; dhe rishikimi i procedurave të thesarit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve përfshi komunalit duke mbuluar 10 mujorin e vitit 2019 në departamentin e financave.

Çështja B8 - Mungesa e planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të AB-së

Gjetja Sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

Njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti. Sipas raportit vjetor të AB-së, nga 25 rekomandimet e dhëna në vitin 2019, pothuajse 48% nuk janë zbatuar ende apo janë në proces të zbatimit.

Ndikimi Mungesa e planit të veprimit dhe ndërmarrja e veprimeve të pamjaftueshme nga menaxhmenti në adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me përsëritjen e mangësive të njëjta.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të komunës së Deçanit ka rezultuar në 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna nuk ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30.09.2019 dhe 15.03.2020) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, tetë rekomandime janë zbatuar, dy janë mbyllur si të pa zbatuara, një është në proces dhe shtatë nuk janë zbatuar ende. Për një përshtkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr .	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarr a	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Kjo kërkon veprime specifike për të konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare përfshirë pronat komunale dhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV. Gjithashtu, Kryetari një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtoj plotësisht të kërkesave për raportim të jashtëm përfshirë edhe përgatitjen e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.	Nuk ka ndryshuar gjendja, kjo e gjetur është paraqitur në kapitullin e pasurisë.	Rekomandim i pazbatuar.
2	Procesi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e mangësive në ekzekutimin e tij në vitin e ardhshëm.	Ekzekutimi i buxhetit është në nivel më të lartë këtë vit.	Rekomandim i zbatuar.
3	Keq klasifikimi i shpenzimeve	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.	Gjendja është në nivelin e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
4	Menaxhimi i Të hyrave.	Kryetari duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike nga drejtoritë përkatëse dhe zyra e financave, dhe adresohen me kohë barrierat që vështirësojnë arkëtimin e të hyrave. Po ashtu, duhet bërë monitorim përmes menaxherit të financave për të siguruar se në fund të ditës të gjitha paratë e gatshme të arkëtuara nga shërbimet deponohen në llogarinë bankare.	Janë ndërmarr veprime nga komuna.	Rekomandim i zbatuar.
5	Të hyrat nga tatimi në pronë	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesës ligjor për verifikim të së paku 20% të pronave të regjistruara si dhe për të reflektuar gjendjen reale në bazën e të dhënave.	Komuna ka arritur të verifikoj 20% të pronave në vitin aktual.	Rekomandim i zbatuar.

6	Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit janë duke u zhvilluar në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit. Po ashtu, komisioni përzgjedhës duhet të ndjekë dhe dokumentojë të gjitha fazat e procesit të rekrutimit.	Janë ndërmarr veprime të pjesshme .	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
7	Paga dhe Mëditje	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit për punët që konsiderohen të realizohen përmes MSHV-ve. Nevojat për pozitat të rregullta të punës të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor, e jo përmes MSHV. Kjo formë e angazhimit të kontraktuesve të aplikohet vetëm në rastet urgjente, dhe kur kërkesat të jenë të arsyetuara nga njësit kërkuese. Pagesat për shërbimet e tilla nuk duhet të tejkalojnë në total vlerën e kontraktuar.	Gjendja është në nivelin e njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se njësit kërkuese planifikojnë drejtë dhe bazohen në nevoja reale vjetore. Në këtë aspekt të bëhen analiza më të detajuara lidhur me planifikimin dhe nivelin e çmimeve të tregut.	Janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i zbatuar.
9	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit të tenderëve vlerësojnë drejtë dhe analizojnë si duhet dëshmitë e ofruara nga ofertuesit. Vetëm ofertuesit që plotësojnë kriteret e dosjes së tenderit t'u ofrohet kontratë publike.	Janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i zbatuar.
10	Çështje të përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë shtimin e mekanizmave të kontrollit në menaxhimin e kontratave duke parandaluar që furnizimet dhe shërbimet të bëhen jashtë kushteve kontraktuale. Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave hartojnë raporte të pranimit dhe ofrojnë informata të plota dhe të mjaftueshme rreth ecurisë së realizimit të kontratave.	Janë ndërmarrë veprime.	Rekomandim i zbatuar.
11	Çështje të përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që të mos hyjë në obligime kontraktuale dhe financiare pa sigurim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe të forcojë disiplinën financiare në pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.	Gjendja është në nivelin e njëjtë	Rekomandim i pazbatuar.
12	Çështje të përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë mos hyrjen në obligime financiare pa u zotuar paraprakisht mjetet e duhura financiare në SIMFK. Urdhër blerjet e përgatitura dhe të nënshkruara duhet ti paraprijnë procesit të furnizimit apo realizimit të punimeve.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura	Rekomandim i zbatuar.

13	Pasuria jofinanciare	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë të regjistruhen në modulën e pasurisë në SIMFK dhe në programin e-pasuri si dhe të aplikohet inventarizimi i plotë dhe kalkulimi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale. Po ashtu, automjetet të shfrytëzohen vetëm pasi të jetë përcaktuar qëllimi dhe kërkesa të jetë aprovuar paraprakisht nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i shfrytëzuesit të automjetit.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar.
14	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar.
15	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e obligimeve dhe të sigurojë mos hyrjen në obligime pa pasur kontratë publike dhe mjete të zotuar. Po ashtu, pagesa e obligimeve të bëhet brenda 30 ditësh nga pranimi i faturës dhe Drejtoria për Buxhet e Financa duhet të mbajë regjistër të plotë dhe të saktë rreth obligimeve të papaguara, si dhe të përmbushë kërkesat ligjore për raportim mujor të obligimeve në Thesar/MF.	Auditori nuk ka identifikuar gjetje të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar.
16	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm si dhe të monitorojë zbatimin e planit të veprimit.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i pazbatuar.
17	Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se procesi buxhetor, plani i prokurimit dhe shpenzimet janë subjekt i analizave dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, të përcaktohet forma e raportimit financiar dhe operativ të menaxhmenti i lartë, dhe rëndësi e veçantë t'i kushtohet përgatitjes së planeve vjetore nga secila drejtori. Në strukturën organizativ të Komunës të jetë edhe pozita e ZKF, si dhe të sigurohet ndarja e drejtë të detyrave.	Janë ndërmarr veprime të pjesshme ..	Rekomandim i mbyllur.
18	Menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete në përgatitjen dhe finalizimin e regjistrit të rreziqeve si dhe të delegojë përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut në drejtorit dhe sektorët e administratës dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Rekomandim i mbyllur.
Nr .	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.		

2	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, ku në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi. Po ashtu, duhet të shtojë masat e sigurisë lidhur me qasjen në dokumente/testet për kandidatë.
3	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit të stafit për MSHV. Si dhe të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuese.
4	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të siguroj se njësitë kërkuese planifikojnë saktë dhe se bazohen në nevojat reale, me qëllim të menaxhimit efikas të kontratës.
5	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të siguroj se për çdo shpenzim për të cilin kërkohet proces i tenderimit duhet të zhvillohen procedura të prokurimit konform kriterëve të përcaktuara ligjore, në të kundërtën furnizimet e pa kontraktuara duhet të ndërpriten.
6	Investime Kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik.
7	Investime Kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherëve të kontratave se nuk kryhet asnjë pagesë për punët të cilat nuk janë përfunduar. Po ashtu, duhet të sigurojë se kontratat përfundojnë sipas planit, në të kundërtën për çdo vonesë të paarsyeshme të aplikohen penalet për ditët në vonesë.
8	Investime Kapitale	Kryetari të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejtë konform kodeve ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së.
9	Çështje të përbashkëta	Kryetari të siguroj një planifikim të drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet duke respektuar afatet kohore të përcaktuara me LMFPF.
10	Pasuria Jofinanciare	Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontrolleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar sistemin e-pasuria në llogaritjen e zhvlerësimit.
11	Pasuria Jofinanciare	Kryetari i duhet të siguroj hartimin e udhëzuesit të brendshëm të inventarizimit pastaj të formoj komisionin e inventarizimit të pasurisë jo financiare me mandat të qartë dhe se raporti përfundimtarë i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare duke i krahasuar shënimet me regjistrat e pasurisë financiare.
12	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari komunës duhet të siguroj se ndërmerren masa në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme sipas ligjit mbi tatimin në pronë, sipas kontratave për pasuritë e dhëna në shfrytëzim, dhe duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve. Gjithashtu duhet shtohen kontrollet që kjo llogari të prezantohet drejt në PFV.
13	Detyrimet e papaguara	Kryetari të siguroj ndërmarrjen e masave për përmirësimin e mekanizmave të brendshme të kontrollit lidhur me respektimin e kriterëve ligjore për raportim të rregullt të obligimeve financiare në MF-Thesar.
14	NJAB	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Deçanit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z.Bashkim Ramosaj

Kryetar i Komunës

Data: 20.05.2020, Decan

